

30 Mënyra për të Qëndruar i Sigurtë në Internet

1. Vendos udhëzues për përdorim të internetit me prindërit dhe të rritur tjerë. Para se të lidhesh në linjë, vendos se sa kohë mendon se është në rregull të shpenzosh për internet çdo ditë dhe vendos se çfarë mund të bësh. Pasi të jeni familjarizuar me internetin, ju dhe prindërit tuaj mund sërish të bisedoni dhe t'i ndryshoni udhëzimet. Vendosni ato diku afër kompjuterit për referencë më të lehtë.
2. Mos e ndani fjalëkalimin tuaj me asnjë tjetër.
3. Para se të ndani çfarëdo informate për veten në internet, merni leje nga prindërit.
4. Vërtetoni dyherë URL-në (adresën e faqes së internetit) para se të shtypni tastin Enter. Sigurohuni se nuk keni bërë gabime drejtshkrimore. Kjo do t'u ndihmojë të siguroheni se do të shkoni në faqen që ju kërkoni e jo diku tjetër.
5. Konsultohu me prindërit apo ndonjë të rritur tjetër para se të hysh në dhomë bisede. Dhoma të ndryshme për bisedë kanë rregulla të ndryshme dhe lloje të ndryshme njerëzish që lidhen në to. Ti dhe prindërit e tu duhet të siguroheni se është vend i përshtatshëm para se ti ta vizitosh.
6. Nëse diçka që sheh ose lexon në linjë të vë në siklet, largohu nga faqja e internetit. Thuaji prindërit apo mësuesit menjëherë.
7. Asnjëherë mos dërgo fotografimin tënde (apo diçka tjetër) dikujt me e-postë përpos nëse prindërit ta lejojnë këtë.
8. Nëse pranon e-postë të padëshiruar, fyese, të keqe, kërcënuese apo ngacmuese, mos u përgjigj në të. Thuaji menjëherë prindërit apo ndonjë të rritur tjetër.
9. Mos harro: Jo çdo gjë që e lexon në internet është e vërtetë.
10. Mos trego moshën para se të marrësh leje nga prindërit.
11. Asnjëherë mos e jep emrin tënd të tërë (emrin dhe mbiemrin). Mos trego emrin para se të marrësh leje nga prindërit apo ndonjë i rritur tjetër.
12. Asnjëherë mos trego adresën e shtëpisë në internet.
13. Pyet prindërit apo një të rritur para se të abonohesh për çfarëdo qoftë në linjë.
14. Mos trego numrin e kartelës së kredisë tënde (apo të dikuj tjetër) pa leje nga njëri nga prindërit.
15. Mos harro, kur je në linjë, varet nga ti se çfarë do të bësh. Mos bën asgjë që nuk dëshiron.
16. Mos hap fajllat apo e-posta nga dikush që nuk e njeh. Ti nuk e di se ç'mund të ketë në brendinë e tyre – fajllat mund të përmbajnë virus apo material fyese.
17. Mba kompjuterin në vend të përbashkët, siç është dhoma familjare, e punës apo ndejes.
18. Asnjëherë mos u pajto të takosh dikë që e ke takuar në internet personalisht pa marrë leje nga prindërit. Nuk do të duhej asnjëherë të takosh dikë që ke njohur në linjë i/e vetme. Nëse vendos të caktosh takim me një mik në linjë, takohuni në vend publik dhe shko me prindin apo kujdestarin.
19. Mos harro se çdo informatë për veten që e ndan mund të shihet nga kushdo që është në linjë.
20. Mos e trego numrin e telefonit.
21. Bisedo me prindërit (apo mësuesin apo ndonjë të rritur tjetër) për llojet e vendeve ku shkon dhe gjërat që i bën dhe sheh kur je në linjë.
22. Zgjidh emër – të ndryshëm nga ai që realisht ke – që do ta përdorish në linjë.
23. Para se të shkosh në vend publik, si dhomë bisede apo forum diskutimi, vendose me prindërit e tu nëse është në rregull ta japësh e-postë adresën tënde.
24. Nëse dikush në linjë të pyet shumë pyetje personale, bëhu dyshues. Ndalo bisedën me ta.
25. Mos e trego emrin e shkollës sate.
26. Gjithmonë kujto se njerëzit në linjë mund të mos jenë ata që thonë se janë. Është shumë e lehtë për njerëzit të shtiren se janë dikush që nuk janë.
27. Mos bën gjëra në linjë që nuk do t'i kishe bërë në jetën reale.
28. Bëhu i kujdesshëm kur dikush të ofron diçka pa pagesë, si dhurata dhe para. Ti nuk e din se ç'motivesh kanë. Refuzo ofertën dhe tregoj prindërve tu.
29. Trajto njerëzit ashtu siç dëshiron të të trajtojnë ty. Asnjëherë mos përdor gjuhë të vrazhdë dhe mos dërgo mesazhe të këqija në linjë.
30. Tasti "ndal" (off) është gjithmonë aty. Përdore nëse duhet. Nuk e ke patjetër të qëndrosh në linjë po qe se nuk dëshiron.